FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.142 | 6 tetor | 2009

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i KM nr.904, datë 26.8.2009	Për një ndryshim dhe shtesë në vendimin nr.644, datë 11.6.2009 të Këshillit të Ministrave "Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Interchange-Kthesa e Kamzës"	6443
Vendim i KM nr.907, datë 26.8.2009	Për hapjen e programeve të reja të studimit, pranë shkollës së lartë universitare, private "Kristal".....	6445
Vendim i KM nr.908, datë 26.8.2009	Për hapjen e programeve të reja të studimit, pranë shkollës së lartë private "Epoka", Tiranë.....	6446
Vendim i KM nr.909, datë 26.8.2009	Për hapjen e programit të studimit, të ciklit të dytë, në universitetin "Aleksandër Xhuvani", Elbasan.....	6447
Vendim i KM nr.910, datë 26.8.2009	Për hapjen e programeve të studimit, të ciklit të dytë, në Universitetin Politeknik të Tiranës.....	6448
Vendim i KM nr.911, datë 26.8.2009	Për licencimin e shkollës së lartë private "Universiteti planetar i Tiranës".....	6448
Vendim i KM nr.912, datë 26.8.2009	Për një ndryshim në vendimin nr.857, datë 5.8.2009 të Këshillit të Ministrave "Për hapjen, në qytetin e Peshkopisë, të filialeve dhe të programeve të studimeve, të fakulteteve të ekonomisë e të administrimit, të edukimit dhe të shkollës së lartë profesionale, të universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës, si dhe për miratimin e kuotave të pranimit e të tarifës së shkollimit në këto programe studimi, për vitin akademik 2009-2010".....	6450
Vendim i KM nr.913, datë 26.8.2009	Për krijimin e Qendrës Kombëtare për Aplikimet Energjetike.....	6451
Vendim i KM nr.915, datë 26.8.2009	Për miratimin e kuadrit makroekonomik dhe të treguesve makroekonomikë e fiskalë, të rishikuar, për periudhën 2010-2012...	6452
Vendim i KM nr.917, datë 29.7.2009	Për një shtesë në vendimin nr.1, datë 10.1.2007 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar	6456

Vendim i KM nr.918, datë 2.9.2009	Për një ndryshim në vendimin nr. 659, datë 3.10.2007 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, me mjete elektronike".....	6457
Vendim i KM nr.919, datë 2.9.2009	Për përcaktimin e autoritetit kontraktues për dhënien me koncesion të hidrocentralit "Topçias", dhe për miratimin e bonusit, në procedurën përzgjedhëse konkurruese, që i jepet shoqërisë.....	6457
Vendim i KM nr.920, datë 2.9.2009	Për përcaktimin e autoritetit kontraktues për dhënien me koncesion të hidrocentralit "Funarës 2", dhe për miratimin e bonusit, në procedurën përzgjedhëse konkurruese, që i jepet shoqërisë.....	6458
Vendim i KM nr.921, datë 2.9.2009	Për përcaktimin e autoritetit kontraktues për dhënien me koncesion të hidrocentraleve "Helmës 1" dhe "Helmës 2", dhe për miratimin e bonusit, në procedurën përzgjedhëse konkurruese, që i jepet shoqërisë.....	6458
Vendim i KM nr.922, datë 2.9.2009	Për përcaktimin e autoritetit kontraktues, për dhënien me koncesion të prodhimit e të kontrollit të pullave fiskale, dhe miratimin e bonusit, në procedurën përzgjedhëse konkurruese, që i jepet shoqërisë.....	6459
Vendim i KM nr.923, datë 2.9.2009	Për një ndryshim në vendimin nr.98, datë 27.1.2009 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e kritereve dhe të procedurave të shitjes së trojeve të ndërmarrjeve apo të objekteve shtetërore, të veçuara, të privatizuara".....	6460
Vendim i KM nr.924, datë 2.9.2009	Për disa ndryshime në vendimin nr.1672, datë 24.12.2008 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin dhe publikimin zyrtar të nomenklaturës së kombinuar të mallrave, 2009".....	6460
Vendim i KM nr.930, datë 2.9.2009	Për miratimin e marrëveshjes "Për disa shtesa dhe ndryshime në marrëveshjen shtesë të koncesionit për 25 hidrocentralet vendore, të lidhur ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe shoqërisë italiane "ESSEGEI", S.P.A, miratuar me vendimin nr.148, datë 22.3.2007 të Këshillit të Ministrave".....	6461
Vendim i KM nr.931, datë 2.9.2009	Për lejimin e kalimit tranzit të disa autokolonave ushtarake italiane, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë.....	6464
Vendim i KM nr.932, datë 2.9.2009	Për miratimin, në parim, të marrëveshjes së grantit, PHRD, No.TF 093096, për përgatitjen e projektit të qeverisjes, financave dhe dhënies së shërbimeve bashkiake.....	6465
Vendim i KM nr.934, datë 2.9.2009	Për përcaktimin e shteteve, me nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale.....	6475
Vendim i KM nr.939, datë 3.9.2009	Për hapjen e programeve të tjera të studimit, pranë shkollës së lartë universitare, private "University of New York, Tirana".....	6475
Vendim i KM nr.940, datë 4.9.2009	Për disa ndryshime në vendimin nr.1694, datë 24.12.2008 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e numrit të punonjësve, për vitin 2009, në ministritë dhe institucionet qendrore"	6477

VENDIM
Nr.904, datë 26.8.2009

PËR NJË NDRYSHIM DHE SHTESË NË VENDIMIN NR.644, DATË 11.6.2009 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR INTERCHANGE-KTHESA E KAMZËS"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", dhe të nenit 8 të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në pikën 3 të vendimit nr.644, datë 11.6.2009 të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

a) Vlera e përgjithshme e shpronësimit 56 619 121 (pesëdhjetë e gjashtë milionë e gjashtëqind e nëntëmbëdhjetë mijë e njëqind e njëzet e një) lekë zëvendësohet me 58 362 571 (pesëdhjetë e tetë milionë e treqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e një) lekë.

b) Krahas tabelës, që përmendet në këtë pikë dhe që i bashkëlidhet vendimit në fuqi, shtohet edhe tabela, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Vlera shtesë prej 1 743 450 (një milion e shtatëqind e dyzet e tre mijë e katërqind e pesëdhjetë) lekësh, të përballohet nga llogaria e veçantë e Ministrisë së Financave, në Bankën e Shqipërisë, "Fondi i shpronësimeve".

3. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit
Drejtoria e Përgjithshme e rrugëve
Drejtoria Juridike
Sektori i Shpronësimeve

LISTA E PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT INTERCHANGE-KTHESA E KAMZËS

Nr	Pronari			Nr.i pas.	ZK	Tokë bujqësore			Tokë truall			Objekt vlera lekë	Vlera totale lekë	Shënime
	Emri	Atësia	Mbiemri			Sip.	Çmimi lekë/m²	Vlera lekë/m²	Sip.m²	Çmimi lekë	Vlera lekë			
1	Mark		Gjinaj	12/103 12/104	8310				70	2580	180600		180600	Konfirmim nga ZRRPP
2	Banka	Arabe	sh.a.	12/105	8310				21	2580	54180		54180	Konfirmim nga ZRRPP
3	Isuf		Lleshi	68/5	2679	191	2950	563450					563450	Konfirmim nga ZRRPP
4	Bukurie	Ali	Doda	68/6	2679	330	2950	973500					973500	Konfirmim nga ZRRPP
5	Gentiana	Ali	Doda	68/7	2679	259	2950	764050					764050	Konfirmim nga ZRRPP
6	Andon Mirela		Dhima Dhima	68/60	2679	462	2950	1362900					1362900	Konfirmim nga ZRRPP
7	Kamza Development			68/57	2679		2950		1810	3870	7004700	457111	7461811	Konfirmim nga ZRRPP vetëm për truallin
8	Miljan		Prespa	440/13	2679	57	2950	168150					168150	Konfirmim nga ZRRPP
9	Ilir	Xhemal	Shtufi	440/122	2679				169	3870	654030		654030	Konfirmim nga ZRRPP
10	Petrit Julian	Xhemal Adem	Mansaku Mehaj	440/121	2679				437	3870	1691190		1691190	Konfirmim nga ZRRPP
11	Saimir Shoqëria		Peko Ukrometal	440/18	2679				335	3870	1296450		1296450	Konfirmim nga ZRRPP
12	Zaim	Sabri	Bardhi	440/1	2679				300	3870	1161000		1161000	Konfirmim nga ZRRPP
13	Ylli		Shima	124/4	2679	119	2950	351050					351050	Konfirmim nga ZRRPP
14	Hatixhe	Shaqir	Jata (Alla)	122/22	2679	215	2950	634250					634250	Konfirmim nga ZRRPP
15	Gezim	Sefer	Nozlli	440/30	2679				397	3870	1536390		1536390	Konfirmim nga ZRRPP
16	Nebi	Ali	Noka	121/18.1	2679				230	3870	890100		890100	Konfirmim nga ZRRPP
17	Aleksandër		Govaci	124/2	2679	190	2950	560500					560500	Konfirmim nga ZRRPP
18	Ramazan		Mema	121/28, 30,32,34	2679	408	2950	1203600					1203600	Konfirmim nga ZRRPP
19	Shoqëria ALFA sh.a			122/18	2679	1599	2950	4717050					4717050	Konfirmim nga ZRRPP
20	Shkëlqim		Alimadhi	123/15	2679				1211	3870	4686570		4686570	Konfirmim nga ZRRPP
21	Hygeija		Hospital	66/33	2679				170	3870	657900		657900	Konfirmim nga ZRRPP
22	Kapllan	Qemal	Mance	124/8	2679	2194	2950	6472300					6472300	Konfirmim nga ZRRPP
23	Bashkëpronarët		Kaziu	66/19	2679	3930	2950	11593500					11593500	Konfirmim nga ZRRPP
24	Syrja Fatime		Kaziu Kaziu	66/38,14	2679	2184	2950	6442800					6442800	Konfirmim nga ZRRPP
25	Syrja Fatime		Kaziu Kaziu	66/39	2679				140	3870	541800		541800	Konfirmim nga ZRRPP
26	Bashkëpronarët Alla			120/1	2679	60	2950	177000					177000	Konfirmim nga ZRRPP
27	Shoq."Scutari Construction"			121/12	2679	531	2950	1566450					1566450	Konfirmim nga ZRRPP
		Totali				**12729**		**37550550**	**5290**		**20354910**	**457111**	**58362571**	

VENDIM
Nr.907, datë 26.8.2009

PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË REJA TË STUDIMIT, PRANË SHKOLLËS SË LARTË UNIVERSITARE, PRIVATE "KRISTAL"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, pika 2, 43, 44 e 45 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e shkollës së lartë universitare, private "Kristal", Tiranë, për hapjen e programeve të studimit, të ciklit të dytë, në formën e studimeve me kohë të plotë, në:

a) Inxhinieri elektronike,

b) Inxhinieri informatike,

c) Inxhinieri e teknologjive të informacionit.

2. Kohëzgjatja normale e programeve të studimit, të ciklit të dytë, të jetë 2 (dy) vite akademike me plotësimin e 120 krediteve. Në përfundim të këtyre programeve të studimit lëshohet diplomë e nivelit të dytë (DND), në:

a) Inxhinieri elektronike,

b) Inxhinieri informatike,

c) Inxhinieri e teknologjive të informacionit.

3. Ngarkohet shkolla e lartë universitare, private "Kristal", Tiranë, që për çdo program studimi të sigurojë, nëpërmjet marrëdhënieve kontraktuale, zhvillimin e disa prej disiplinave kryesore formuese të specialitetit, nga një person akademik i huaj, me kualifikimet e nevojshme.

4. Shkolla e lartë universitare, private "Kristal", Tiranë, ta fillojë veprimtarinë mësimore për programet e studimit, të përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi, pasi të ketë marrë, jo më vonë se dy javë para fillimit të vitit akademik, lejen përkatëse nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës.

Ministri e lëshon lejen, pasi vlerëson se institucioni mësimor ka përmbushur angazhimet e deklaruara, në përputhje me udhëzimin e tij për këtë qëllim.

5. Ndryshimet në vendndodhje, forma studimi, plane dhe programe, si dhe në elemente të tjera, të miratuara, bëhen pas miratimit nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

6. Shkolla e lartë universitare, private, "Kristal", Tiranë, duhet t'i nënshtrohet procesit të akreditimit institucional dhe të këtyre programeve të studimit, brenda afateve të përcaktuara në ligjin në fuqi.

7. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucion dhe për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.908, datë 26.8.2009

PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË REJA TË STUDIMIT, PRANË SHKOLLËS SË LARTË, PRIVATE "EPOKA", TIRANË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, pika 2, 43, 44 e 45 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e shkollës së lartë private "Epoka", Tiranë, për hapjen e programeve të studimit të ciklit të dytë në:

a) Arkitekturë;
b) Inxhinieri kompjuterike;
c) Shkenca politike dhe marrëdhënie ndërkombëtare;
ç) Financë-bankë;
d) Administrim-biznes.

2. Këto programe studimi, të ciklit të dytë, realizohen me 120 kredite, me një kohëzgjatje 2 vite akademike. Në përfundim të programeve të këtyre programeve të studimit, lëshohet diplomë e nivelit të dytë (DND), në:

a) Arkitekturë;
b) Inxhinieri kompjuterike;
c) Shkenca politike dhe marrëdhënie ndërkombëtare;
ç) Financë-bankë;
d) Administrim-biznes.

3. Lejimin e shkollës së lartë private "Epoka", Tiranë, për hapjen e programeve "Master i nivelit të dytë", në:

a) Arkitekturë;
b) Inxhinieri kompjuterike;
c) Shkenca politike dhe marrëdhënie ndërkombëtare;
ç) Studime europiane;
d) Financë-bankë;
dh) Administrim-biznes.

4. Programet e studimit "Master i nivelit të dytë" do të jenë programe studimi, të ciklit të tretë, dhe realizohen me plotësimin e 60 krediteve. Në përfundim të këtyre programeve lëshohet diplomë "Master i nivelit të dytë" (MND), në:

a) Arkitekturë";
b) Inxhinieri kompjuterike;
c) Shkenca politike dhe marrëdhënie ndërkombëtare;
ç) Studime evropiane;
d) Financë-bankë;
dh) Administrim-biznes.

5. Ngarkohet shkolla e lartë private "Epoka", Tiranë, që, për çdo program studimi, të sigurojë, nëpërmjet marrëdhënieve kontraktuale, zhvillimin e disa prej disiplinave kryesore formuese të specialitetit, nga një person akademik i huaj, me kualifikimin e nevojshëm.

6. Shkolla e lartë private "Epoka", Tiranë, ta fillojë veprimtarinë mësimore për programet e studimit, të përcaktuara në pikat 1 dhe 3 të këtij vendimi, pasi të ketë marrë, jo më vonë se dy javë para fillimit të vitit akademik, lejen përkatëse nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës.

Ministri e lëshon lejen, pasi vlerëson se institucioni mësimor ka përmbushur angazhimet e deklaruara, në përputhje me udhëzimin e tij për këtë qëllim.

7. Shkolla e lartë, private "Epoka", Tiranë, pas marrjes së lejes përkatëse nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës, strukturohet si universitet dhe emërtohet "Universiteti "Epoka"".

8. Ndryshimet në vendndodhje, forma studimi, plane dhe programe, si dhe në elemente të tjera, të miratuara, bëhen pas miratimit nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

9. Ky institucion duhet t'u nënshtrohet procesit të akreditimit institucional dhe të këtyre programeve të studimit, brenda afateve të përcaktuara në ligjin në fuqi.

10. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucion dhe për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.909, datë 26.8.2009

PËR HAPJEN E PROGRAMIT TË STUDIMIT, TË CIKLIT TË DYTË, NË UNIVERSITETIN "ALEKSANDËR XHUVANI", ELBASAN

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26 e 42 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen, në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, të universitetit "Aleksandër Xhuvani", Elbasan, të programit të studimit, të ciklit të dytë, matematikë e zbatuar, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë e nivelit të dytë, në matematikë e zbatuar.

2. Ky program i ciklit të dytë realizohet me 120 kredite dhe kohëzgjatja normale e tij është dy vite.

3. Programi i studimit matematikë e zbatuar ta fillojë veprimtarinë mësimore në vitin akademik 2009-2010.

4. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2009, miratuar për universitetin "Aleksandër Xhuvani", Elbasan.

5. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe universiteti "Aleksandër Xhuvani", Elbasan për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.910, datë 26.8.2009

PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMIT, TË CIKLIT TË DYTË, NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK TË TIRANËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26 e 42 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen, në Fakultetin e Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike, të Universitetit Politeknik të Tiranës, të programeve të studimit, të ciklit të dytë, "Inxhinieri matematike" dhe "Inxhinieri fizike".
2. Në përfundim të këtyre programeve të studimit lëshohet, përkatësisht, diplomë e nivelit të dytë, DND, në "Inxhinieri matematike" dhe "Inxhinieri fizike".
3. Këto programe studimi realizohen me 120 kredite dhe kohëzgjatja normale e tyre është dy vite akademike.
4. Këto programe studimi ta fillojnë veprimtarinë mësimore në vitin akademik 2009-2010.
5. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2009, miratuar për Universitetin Politeknik të Tiranës.
6. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Universiteti Politeknik i Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.911, datë 26.8.2009

PËR LICENCIMIN E SHKOLLËS SË LARTË, PRIVATE "UNIVERSITETI PLANETAR I TIRANËS"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, pika 2, 43, 44 e 45 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Licencimin e shkollës së lartë private "Universiteti planetar i Tiranës", e cila do ta ushtrojë veprimtarinë në qytetin e Tiranës.
2. Shkolla e lartë private "Universiteti planetar i Tiranës", të organizohet në dy fakultete:

a) Fakulteti i Edukimit dhe Shkencave Sociale, që do të ofrojë programet e studimit, të ciklit të parë, në:

i) Mësuesi për arsimin parashkollor;
ii) Psikologji;
iii) Sociologji;
iv) Mësuesi për arsimin fillor.

b) Fakultetin e Shkencave të Zbatuara, që do të ofrojë programet e studimit, të ciklit të parë, në:

i) Teknologji informacioni;

ii) Informatikë ekonomike;

iii) Infermieri e përgjithshme;

iv) Teknologji dhe shkenca farmaceutike.

3. Shkolla e lartë, private "Universiteti planetar i Tiranës" të ofrojë programet e studimit të ciklit të parë, me kohëzgjatje 3 vite akademike dhe me plotësimin e, së paku, 180 krediteve. Në përfundim të këtyre programeve të studimit lëshohet diplomë e nivelit të parë (DNP), në:

i) Mësuesi për arsimin parashkollor;

ii) Psikologji;

iii) Sociologji;

iv) Mësuesi për arsimin fillor;

v) Teknologji informacioni;

vi) Informatikë ekonomike;

vii) Infermieri e përgjithshme;

viii) Teknologji dhe shkenca farmaceutike.

4. Ngarkohet shkolla e lartë private "Universiteti planetar i Tiranës", që, për çdo program studimi, të sigurojë, nëpërmjet marrëdhënieve kontraktuale, zhvillimin e disa prej disiplinave kryesore formuese të specialitetit, pas vitit të parë, nga një personel akademik i huaj, me kualifikimin e nevojshëm.

5. Shkolla e lartë private "Universiteti planetar i Tiranës" ta fillojë veprimtarinë mësimore për programet e studimit, të përcaktuara në pikën 2 të këtij vendimi, pasi të ketë marrë, jo më vonë se tri javë para fillimit të vitit akademik, lejen përkatëse nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës.

Ministri e lëshon lejen, pasi vlerëson se institucioni privat i arsimit të lartë ka përmbushur angazhimet e deklaruara, në përputhje me udhëzimin e tij për këtë qëllim.

6. Ndryshimet në vendndodhje, plane, forma studimi dhe programe, si dhe në elemente të tjera, të miratuara, bëhen pas miratimit nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

7. Shkolla e lartë private "Universiteti planetar i Tiranës" duhet t'i nënshtrohet procesit të akreditimit institucional dhe të programeve të studimit, brenda afateve të përcaktuara në ligjin në fuqi.

8. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucion dhe për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.912, datë 26.8.2009

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.857, DATË 5.8.2009 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR HAPJEN, NË QYTETIN E PESHKOPISË, TË FILIALEVE DHE TË PROGRAMEVE TË STUDIMEVE, TË FAKULTETEVE TË EKONOMISË E TË ADMINISTRIMIT, TË EDUKIMIT DHE TË SHKOLLËS SË LARTË PROFESIONALE, TË UNIVERSITETIT "ALEKSANDËR MOISIU", DURRËS, SI DHE PËR MIRATIMIN E KUOTAVE TË PRANIMIT E TË TARIFËS SË SHKOLLIMIT NË KËTO PROGRAME STUDIMI, PËR VITIN AKADEMIK 2009-2010"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8, pika 1, 11, pika 2, shkronja "b", 26, 33, 42 e 75 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pika 3 e vendimit nr.857, datë 5.8.2009 të Këshillit të Ministrave, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"3. Filiali i Fakultetit të Edukimit do të ofrojë programet e studimit, të ciklit të parë, në:

a) Matematikë-Fizikë, në përfundim të të cilit lëshohet "Diplomë e nivelit të parë" (DNP), në matematikë-fizikë;

b) Matematikë-Informatikë, në përfundim të të cilit lëshohet "Diplomë e nivelit të parë" (DNP), në matematikë-informatikë;

c) Informatikë-Anglisht, në përfundim të të cilit lëshohet "Diplomë e nivelit të parë" (DNP), në informatikë-anglisht;

ç) Gjuhë-Letërsi-Anglisht, në përfundim të të cilit lëshohet "Diplomë e nivelit të parë" (DNP), në gjuhë-letërsi-anglisht;

d) Biologji-Kimi, në përfundim të të cilit lëshohet "Diplomë e nivelit të parë" (DNP), në biologji-kimi;

dh) Psikologji-Sociologji, në përfundim të të cilit lëshohet "Diplomë e nivelit të parë" (DNP), në psikologji-sociologji;

e) Procese formimi, në përfundim të të cilit lëshohet "Diplomë e nivelit të parë" (DNP), në procese formimi".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.913, datë 26.8.2009

PËR KRIJIMIN E QENDRËS KOMBËTARE PËR APLIKIMET ENERGJETIKE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 10 të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003 "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave", të neneve 2, pika 1, shkronja "ç", pikat 2, shkronjat "a" e "b", 4, 13, 15, pikat 1 e 2, shkronja "a" të ligjit nr.10081, datë 23.2.2009 "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e Qendrës Kombëtare për Aplikimet Energjetike (në vijim QKAE), si institucion bashkërendues dhe lehtësues, për procedurat e marrjes së lejeve dhe/ose të autorizimeve të nevojshme për ngritjen dhe funksionimin e të gjitha llojeve të projekteve, në fushën e energjisë elektrike.

2. QKAE-ja është institucion publik qendror, buxhetor, me personalitet juridik, në varësi të ministrit, që mbulon fushën e ekonomisë.

3. QKAE-ja e ka selinë në Tiranë.

4. QKAE-ja financohet nga Buxheti i Shtetit.

5. QKAE-ja ka këto funksione:

- Lehtëson procesin e lëshimit të licencave, të lejeve, autorizimeve dhe akteve të tjera administrative, për ndjekjen e të gjitha llojeve të projekteve, në fushën e energjisë elektrike, nga të gjitha burimet e mundshme, nëpërmjet bashkërendimit të procedurave për dhënien e licencave, të autorizimeve apo lejeve nga institucionet a entet publike përkatëse;
- Mbështet me analiza dhe sugjerime nismat e reja të reformës rregullatore, të cilat lidhen me funksionin parësor të kësaj qendre;
- Jep mendime dhe bën oponencë për nisma, ligjore dhe nënligjore, për institucionet publike, që lidhen me funksionin parësor të kësaj qendre.
- Informon dhe këshillon subjektet private për kriteret dhe procedurat për licencimin, lejimin apo autorizimin e projekteve në fushën e energjisë elektrike.

6. QKAE-ja funksionon sipas modelit të "Qendrës me një ndalesë të vetme".

7. Veprimtaria e QKAE-së drejtohet nga drejtori i përgjithshëm, i cili emërohet nga ministri, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

8. Titullari i QKAE-së lirohet nga detyra për shkaqet dhe sipas procedurave të parashikuara në pikën 1 të nenit 21 të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil". Vendimi për lirimin e titullarit merret nga ministri përgjegjës për ekonominë.

9. Për përzgjedhjen e nëpunësve të QKAE-së zbatohen procedurat e përcaktuara në ligjin nr.8549, datë 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil".

10. Marrëdhëniet e punës të punonjësve të tjerë të QKAE-së që kryejnë detyra të karakterit mbështetës, rregullohen sipas Kodit të Punës dhe dispozitave të tjera, ligjore dhe nënligjore, të dala në mbështetje dhe në zbatim të tij.

11. Zhvillimi i procedurave për rekrutimin e nëpunësve të QKAE-së, në fazën fillestare të krijimit, kryhet nga strukturat përkatëse të shërbimeve mbështetëse, të ministrisë përgjegjëse për ekonominë.

12. Struktura dhe organika e QKAE-së miratohen nga Kryeministri.

13. Numri i punonjësve të QKAE-së, me vendim të Këshillit të Ministrave, i shtohet numrit të përgjithshëm të Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

14. Buxheti i QKAE-së miratohet së bashku me buxhetin vjetor të Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, si zë i veçantë.

Buxheti i QKAE-së, për periudhën në vazhdim, të vitit 2009, të përballohet nga fondet e Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

15. Deri në rekrutimin e stafit të nevojshëm, shërbimet e financës, të llogarisë dhe prokurimit të QKAE-së të kryhen nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

16. Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL) dhe Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), nën drejtimin e Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës të evidentojnë ndryshimet e nevojshme të akteve, ligjore dhe nënligjore, në fuqi, për të mundësuar funksionimin e QKAE-së në ato fusha veprimtarie, të cilat nuk i janë nënshtruar zbatimit të ligjit nr.10081, datë 23.2.2009 "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

17. Deri në datën e hyrjes në fuqi të ndryshimeve të nevojshme ligjore sipas pikës 16 të këtij vendimi, QKAE-ja do të kryejë funksionet e saj, të përcaktuara në këtë vendim, për aq sa kjo lejohet nga legjislacioni në fuqi.

18. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Ministria e Financave dhe Departamenti i Administratës Publike për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.915, datë 26.8.2009

PËR MIRATIMIN E KUADRIT MAKROEKONOMIK DHE TË TREGUESVE MAKROEKONOMIKË E FISKALË, TË RISHIKUAR, PËR PERIUDHËN 2010-2012

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 23 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e kuadrit makroekonomik dhe të treguesve makroekonomikë e fiskalë, të rishikuar, për periudhën 2010-2012, sipas lidhjeve nr.1, "Treguesit kryesorë makroekonomikë" dhe nr.2 e nr.2/1, "Treguesit fiskalë, sipas buxhetit të konsoliduar", që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr. 1

Treguesit kryesorë makroekonomik

Treguesit	Njësia	2006	2007	2008	2009 Para.	2010 Para.	2011 Para.	2012 Para.
				(Cmimet)				
Inflacioni (mesatar)	%	2.4	2.9	3.4	2.3	3.0	3.0	3.0
Inflacioni (fund-viti)	%	2.6	3.1	2.2	2.8	3.0	3.1	3.1
Deflatori i PBB	%	2.7	3.9	3.5	2.4	3.3	3.0	3.0
Kursi i këmbimit (mesatar)	Lek / USD	98.1	90.4	83.9	96.5	97.0	96.8	96.8
Kursi i këmbimit (mesatar)	Lek / Euro	123.0	123.9	122.8	130.0	129.0	127.1	127.0
Kursi i këmbimit (fund-viti)	Lek / Euro	123.7	120.9	122.8	131.0	130.0	128.0	127.9
				(Produkti i Brendshëm Bruto, Punësimi)				
Rritja reale e PBB	%	5.4	6.0	8.0	5.8	6.8	7.1	7.0
PBB	Lek miliardë	882.2	971.2	1085.7	1176.3	1298.2	1433.2	1579.2
PBB për banor	Lek mijë	280.1	307.2	342.7	369.4	406.4	447.0	490.8
Norma e papunësisë	%	13.8	13.2	12.7	12.7	12.1	10.8	9.7
				(Bilanci Kursime - Investime)				
Kursimet e brendshme	% të PBB	32.4	28.0	25.3	24.0	24.3	26.1	27.3
Publike	% të PBB	2.9	3.3	4.3	4.1	4.7	4.9	5.1
Private	% të PBB	29.5	24.7	21.0	19.9	19.7	21.2	22.2
Kursimet e huaja	% të PBB	6.6	10.6	14.9	14.6	12.8	10.8	9.7
Investimet	% të PBB	39.0	38.6	40.2	38.5	37.2	36.9	37.0
Publike	% të PBB	6.8	6.5	9.5	9.8	8.0	7.7	7.5
nga të cilat: Qeveria qendrore		5.8	5.9	8.6	8.7	7.0	6.6	6.5
Private	% të PBB	32.2	32.1	30.7	28.7	29.1	29.2	29.5
				(Treguesit Fiskal)				
Të ardhurat totale	Lek miliard	229.4	251.6	291.2	327.1	368.3	407.8	450.9
Shpenzimet totale	Lek miliard	258.8	285.7	351.5	401.9	417.8	454.9	496.6
Bilanci i përgjithshëm	Lek miliard	-29.4	-34.1	-60.3	-74.8	-49.5	-47.1	-45.7
Huamarrja e Brendshme Neto	Lek miliard	20.7	17.0	18.0	40.4	40.1	38.0	70.2
Të Ardhura nga Privatizimet	Lek miliard	2.0	13.2	5.5	27.8	0.3	0.3	0.3
Huamarrja e Huaj Neto	Lek miliard	5.3	5.0	35.5	6.6	9.1	8.8	-24.7
Të ardhurat totale	% të PBB	26.0	25.9	26.8	27.8	28.4	28.5	28.6
Shpenzimet totale	% të PBB	29.3	29.4	32.4	34.2	32.2	31.7	31.4
Bilanci i përgjithshëm	% të PBB	-3.3	-3.5	-5.5	-6.4	-3.8	-3.3	-2.9
Bilanci Primar	% të PBB	-0.5	-0.9	-2.7	-3.2	-0.6	-0.3	-0.2
Huamarrja e brendshme neto	% të PBB	2.4	1.8	1.7	3.4	3.1	2.7	4.4
Të ardhura nga privatizimet	% të PBB	0.2	1.4	0.5	2.4	0.0	0.0	0.0
Huamarrja e huaj neto	% të PBB	0.6	0.5	3.3	0.6	0.7	0.6	-1.6
Borxhi publik total	% të PBB	56.1	53.2	54.9	57.3	55.5	53.5	51.5
I Brendshëm	% të PBB	39.6	38.0	36.9	35.0	34.6	34.0	35.4
I Huaj	% të PBB	16.5	15.2	18.0	22.3	20.9	19.5	16.2
				(Treguesit Monetarë) /1				
Paraja e gjerë (M3)	% të PBB	76.4	78.4	75.1				
Rritja	%	16.7	12.9	7.1				
Shpejtësia (V)	Numër	1.3	1.3	1.3				
Kredia drejt sektorit privat	% të PBB	21.6	29.2	34.6				
Rritja	%	57.6	48.5	32.4				
				(Treguesit e Sektorit të Huaj)				
Bilanci tregtar (Mallra & Shërbime)	% të PBB	-23.6	-26.7	-26.7	-25.0	-24.0	-21.9	-20.7
Mallra	% të PBB	-23.1	-26.8	-27.5	-26.0	-25.1	-23.6	-22.2
Rritja e eksporteve	%	17.7	25.5	15.6	-14.0	18.0	16.7	16.0
Rritja e importeve	%	12.9	27.1	14.8	-1.9	9.1	7.1	7.2
Bilanci I llogarisë korrente	% të PBB	-6.6	-10.6	-14.9	-14.6	-12.8	-10.8	-9.7
Bilanci i pagesave	% të PBB	2.9	1.9	2.2	-2.7	-0.3	1.3	1.9
Bilanci i pagesave	Euro milion	206.5	148.6	191.9	-240.0	-34.2	150.0	238.1

Burimi: INSTAT, Banka e Shqipërisë, Ministria e Financave

1/ Parashikimet e MF të treguesve monetarë për vitet 2009 - 2012 nuk janë paraqitur për të evituar keq perceptimet e mundëshme, pasi disa prej këtyre treguesve janë objektiva sasiorë për autoritetin monetar

TREGUESIT FISKALE SIPAS BUXHETIT TE KONSOLIDUAR
ne milion leke (million lek)

Nr.	E M E R T I M I	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012
					I Pritshmi	PBA	PBA	PBA
	TOTALI TE ARDHURAVE	229,444	251,555	291,238	327,116	368,309	407,814	450,907
I.	Ndihmat	8,025	1,280	4,228	6,313	6,490	7,145	8,074
II.	Te ardhura tatimore	205,523	228,164	264,421	295,981	337,946	375,363	416,009
II.1	*Nga Tatimet dhe Doganat*	155,102	176,808	205,292	222,668	254,714	281,529	311,182
1	*Tatimi mbi Vleren e Shtuar*	74,268	87,771	107,094	114,657	130,263	143,885	158,216
2	*Tatmi mbi Fitimin*	22,258	21,077	18,108	19,436	22,852	25,662	28,810
3	*Akcizat*	22,997	28,731	32,510	36,795	43,770	48,444	53,932
4	*Tatimi mbi te Ardhurat Personale*	8,580	14,850	24,498	28,734	32,610	36,307	40,535
5	*Taksa Nacionale dhe te tjera*	13,008	14,531	14,423	15,210	16,879	18,502	20,187
6	*Taksa Doganore*	13,991	9,848	8,660	7,837	8,341	8,730	9,502
II.2	*Te ardhura nga Pushteti Lokal*	11,112	9,366	11,307	18,412	20,947	23,434	26,153
II.3	*Te ardh Buxh. Pavarur (kontribute)*	39,309	41,989	47,822	54,901	62,285	70,400	78,673
III.	Te ardhura jotatimore	15,895	22,112	22,588	24,822	23,873	25,306	26,824
	TOTALI I SHPENZIMEVE	258,816	285,674	351,492	401,907	417,823	454,910	496,648
I.	Shpenzime Korrente	204,860	224,976	250,298	285,430	314,969	345,928	378,840
I.1	*Personeli*	56,709	59,087	66,621	59,546	66,790	75,226	83,125
I.2	*Interesat*	25,006	25,594	31,307	36,740	41,236	42,316	42,803
1	*Te brendshme*	22,978	23,499	28,386	31,420	34,496	34,000	35,000
2	*Te Huaja*	2,028	2,096	2,921	5,320	6,740	8,316	7,803
I.3	*Shpenzime Operative Mirembajtje*	22,794	25,259	28,788	34,660	40,402	47,348	55,398
I.4	*Subvencionet*	3,835	3,536	2,555	2,022	2,500	2,900	2,900
I.5	*Mbeshtetje per Energjine*	0	5,000	0	0	0	0	0
I.6	*Shpenzime per Sig.Sociale dhe transferime te tjera*	60,029	69,892	76,199	95,866	104,967	113,084	121,179
I.7	*Buxheti lokal*	22,713	21,340	27,079	36,835	39,433	42,634	47,732
I.8	*Shpenzime te tjera*	13,775	15,268	17,750	17,991	18,942	21,220	24,003
II.	Fondi Rezerve	0	0	0	14,021	12,452	13,873	15,772
III.	Shpenzime Kapitale	51,108	57,040	93,783	102,456	90,402	95,109	102,036
IV	Transferta te ndryshme	2,848	3,658	7,411	0	0	0	0
	DEFIÇITI	-29,372	-34,119	-60,254	-74,791	-49,514	-47,095	-45,740
	FINANCIMI DEFIÇITIT	29,372	34,119	60,254	74,791	49,514	47,095	45,740
	Brendshem	23,623	28,829	24,417	68,217	40,399	38,345	70,480
	Te ardhura nga Privatizimi	1,972	13,246	5,538	27,793	300	300	300
	Hua-marrje e brendeshme	20,742	17,039	18,012	40,424	40,099	38,045	70,180
	Te tjera	909	-1,456	866	0	0	0	0
	I Huaj	5,749	5,289	35,837	6,574	9,115	8,750	-24,740
	Hua afatgjate(e marre)	9,936	9,109	39,794	13,244	17,315	18,000	19,000
	Ndryshimi i gjendjes se arkes	403	279	292	0	0	0	0
	Ripagesat	-4,590	-4,098	-4,248	-6,670	-8,200	-9,250	-43,740
	Memo:							
	Borxhi publik total	494,584	516,860	595,780	673,695	719,855	767,202	813,441
	I Brendshem	348,935	369,536	400,456	411,698	448,743	487,340	558,319
	I Huaj	145,649	147,324	195,324	261,997	271,112	279,862	255,122
	PBB nominal	882,209	971,222	1,085,674	1,176,349	1,298,178	1,433,165	1,579,194

Burimi: Ministria e Financave

Lidhja nr. 2/1

TREGUESIT FISKALE SIPAS BUXHETIT TE KONSOLIDUAR

ne % te PBB

Nr.	EMERTIMI	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012
					I Pritshmi	PBA	PBA	PBA
	TOTALI TE ARDHURAVE	26.0	25.9	26.8	27.8	28.4	28.5	28.6
I.	Ndihmat	0.9	0.1	0.4	0.5	0.5	0.5	0.5
II.	Te ardhura tatimore	23.3	23.5	24.4	25.2	26.0	26.2	26.3
II.1	*Nga Tatimet dhe doganat*	17.6	18.2	18.9	18.9	19.6	19.6	19.7
1	*Tatimi mbi vleren e Shtuar*	8.4	9.0	9.9	9.7	10.0	10.0	10.0
2	*Tatmi mbi Fitimin*	2.5	2.2	1.7	1.7	1.8	1.8	1.8
3	*Akcizat*	2.6	3.0	3.0	3.1	3.4	3.4	3.4
4	*Tatimi mbi te Ardhurat Personale*	1.0	1.5	2.3	2.4	2.5	2.5	2.6
5	*Taksa Nacionale dhe te tjera*	1.5	1.5	1.3	1.3	1.3	1.3	1.3
6	*Taksa Doganore*	1.6	1.0	0.8	0.7	0.6	0.6	0.6
II.2	*Te ardhura nga Pushteti Lokal*	1.3	1.0	1.0	1.6	1.6	1.6	1.7
II.3	*Te ardh Buxh. Pavarur (kontribute)*	4.5	4.3	4.4	4.7	4.8	4.9	5.0
III.	Te ardhura Jotatimore	1.8	2.3	2.1	2.1	1.8	1.8	1.7
	TOTALI I SHPENZIMEVE	29.3	29.4	32.4	34.2	32.2	31.7	31.4
I.	Shpenzime Korrente	23.2	23.2	23.1	24.3	24.3	24.1	24.0
I.1	*Personeli*	6.4	6.1	6.1	5.1	5.1	5.2	5.3
I.2	*Interesat*	2.8	2.6	2.9	3.1	3.2	3.0	2.7
1	*Te brendshme*	2.6	2.4	2.6	2.7	2.7	2.4	2.2
2	*Te Huaja*	0.2	0.2	0.3	0.5	0.5	0.6	0.5
I.3	*Shpenzime Operative Mirembajtje*	2.6	2.6	2.7	2.9	3.1	3.3	3.5
I.4	*Subvencionet*	0.4	0.4	0.2	0.2	0.2	0.2	0.2
I.5	*Mbeshtetje per Energjine*	0.0	0.5	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
I.6	*Shpenzime per Sig.Sociale dhe transferime te tjera*	6.8	7.2	7.0	8.1	8.1	7.9	7.7
I.7	*Buxheti lokal*	2.6	2.2	2.5	3.1	3.0	3.0	3.0
I.8	*Shpenzime te tjera*	1.6	1.6	1.6	1.5	1.5	1.5	1.5
II.	Fondi Rezerve	0.0	0.0	0.0	1.2	1.0	1.0	1.0
III.	Shpenzime Kapitale	5.8	5.9	8.6	8.7	7.0	6.6	6.5
IV	Transferta te ndryshme	0.3	0.4	0.7	0.0	0.0	0.0	0.0
	DEFIÇITI	-3.3	-3.5	-5.5	-6.4	-3.8	-3.3	-2.9
	FINANCIMI DEFIÇITIT	3.3	3.5	5.5	6.4	3.8	3.3	2.9
	Brendshem	2.7	3.0	2.2	5.8	3.1	2.7	4.5
	Te ardhura nga Privatizimi	0.2	1.4	0.5	2.4	0.0	0.0	0.0
	Hua-marrje e brendeshme	2.4	1.8	1.7	3.4	3.1	2.7	4.4
	Te tjera	0.1	-0.1	0.1	0.0	0.0	0.0	0.0
	I Huaj	0.7	0.5	3.3	0.6	0.7	0.6	-1.6
	Hua afatgjate(e marre)	1.1	0.9	3.7	1.1	1.3	1.3	1.2
	Ndryshimi i gjendjes se arkes	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
	Ripagesat	-0.5	-0.4	-0.4	-0.6	-0.6	-0.6	-2.8
	Memo:							
	Borxhi publik total	56.1	53.2	54.9	57.3	55.5	53.5	51.5
	I Brendshem	39.6	38.0	36.9	35.0	34.6	34.0	35.4
	I Huaj	16.5	15.2	18.0	22.3	20.9	19.5	16.2

Burimi: Ministria e Financave

VENDIM
Nr.917, datë 29.7.2009

PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR.1, DATË 10.1.2007 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË PROKURIMIT PUBLIK", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 75 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pas shkronjës "b/1" të pikës 4 "Hapja dhe vlerësimi i ofertave" të kreut V "Zhvillimi i procedurave", të rregullave të prokurimit publik, që i bashkëlidhen vendimit nr.1, datë 10.1.2007 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të shtohet shkronja "b/2", me këtë përmbajtje:

"b/2. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve ndalohet të kualifikojë për punë publike, të prokuruara sipas ligjit të prokurimit publik, operatorët ekonomikë, që janë fitues dhe/apo kanë në proces, në të njëjtën kohë, si kontraktorë/nënkontraktorë, një investim/investime, sipas një kontrate apo kontratave të lidhura a në proces për t'u lidhur, sipas ligjit për prokurimin publik, i cili në çastin e hapjes së ofertave nuk i ka përfunduar punimet fizike, në masën 70 për qind të vëllimeve të përgjithshme të punës. Përcaktimi i mësipërm vlen edhe për rastin e bashkimit të operatorëve, ku secili prej tyre, për t'u kualifikuar për punë publike, duhet të ketë përfunduar punimet fizike, në masën 70 për qind të vëllimeve të përgjithshme të punës, që ai ka marrë përsipër të realizojë, në përputhje me kontratën e bashkëpunimit.

Gjithashtu, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve ndalohet të kualifikojë për punë publike, të prokuroria sipas ligjit të prokurimit publik, ata kandidatë, të cilët, në çastin e hapjes së ofertave, brenda së njëjtës periudhë, janë kontraktorë/nënkontraktorë me këtë autoritet për kontratë/kontrata të lidhura, me vlerë të përbashkët ose të veçantë, jo më të madhe se 100 për qind i kufirit maksimal, që disponon kandidati, sipas licencës profesionale, të lëshuar nga Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit. Në kuptim të përcaktimit të mësipërm, fjala "periudhë" nënkupton kohëzgjatjen e investimit të kryer sipas ligjit për prokurimin publik nga çasti i shpalljes fitues e deri në kolaudimin e objektit/investimit.".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.918, datë 2.9.2009

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 659, DATË 3.10.2007 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË PROKURIMIT PUBLIK, ME MJETE ELEKTRONIKE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 22 e 75 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Shkronja "ç" e pikës 14, në tekstin "Rregullat e prokurimit publik, me mjete elektronike", që i bashkëlidhet vendimit nr.659, datë 3.10.2007 të Këshillit të Ministrave, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"ç) Paralel me sistemin e back-up-it, në mjediset e Kryeministrisë do të instalohet edhe një server i tretë, i cili do të regjistrojë të gjitha proceset dhe ndërhyrjet në sistemin e prokurimit elektronik. Në server lejohet të ndërhyhet, në përputhje me rregulloren e miratuar nga Kryeministri, vetëm në rast të ndonjë pretendimi apo për qëllime auditimi, në prani të sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave dhe, të paktën, të dy zyrtarëve të tjerë, të përmendur në pikën 19.".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.919, datë 2.9.2009

PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES PËR DHËNIEN ME KONCESION TË HIDROCENTRALIT "TOPÇIAS", DHE PËR MIRATIMIN E BONUSIT, NË PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE, QË I JEPET SHOQËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 3, e 23, pika 3, shkronja "b", të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 "Për koncesionet", me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autoriteti kontraktues për kryerjen e procedurave ligjore, për dhënien me koncesion, të formës "BOT" (ndërtim, operim dhe transferim), të hidrocentralit "Topçias", është Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

2. Miratimin e bonusit prej 2 për qind të pikëve, për rezultatin, teknik dhe financiar, në procedurën konkurruese përzgjedhëse (propozim i pakërkuar), që i jepet shoqërisë "DIETA" sh.p.k.

3. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, në procedurën konkurruese, për dhënien me koncesion të hidrocentralit "Topçias", të kërkojë shprehje interesi dhe të pranojë oferta, për të gjithë pjesën e lirë të skemës, ku përfshihet ndërtimi i këtij hidrocentrali.

4. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.920, datë 2.9.2009

PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, PËR DHËNIEN ME KONCESION TË HIDROCENTRALIT "FUNARËS 2", DHE PËR MIRATIMIN E BONUSIT, NË PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE, QË I JEPET SHOQËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 3, e 23, pika 3, shkronja "b", të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006, "Për koncesionet", me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autoriteti kontraktues për kryerjen e procedurave ligjore, për dhënien me koncesion, të formës "BOT" (ndërtim, operim dhe transferim), të hidrocentralit "Funarës 2", është Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.
2. Miratimin e bonusit prej 2 për qind të pikëve, për rezultatin, teknik dhe financiar, në procedurën konkurruese përzgjedhëse (propozim i pakërkuar), që i jepet shoqërisë "ZECORONDA" sh.p.k.
3. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, në procedurën konkurruese, për dhënien me koncesion të hidrocentralit "Funarës 2", të kërkojë shprehje interesi dhe të pranojë oferta, për të gjithë pjesën e lirë të skemës, ku përfshihet ndërtimi i këtij hidrocentrali.
4. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.921, datë 2.9.2009

PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, PËR DHËNIEN ME KONCESION TË HIDROCENTRALEVE "HELMËS 1" DHE "HELMËS 2", DHE PËR MIRATIMIN E BONUSIT, NË PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE, QË I JEPET SHOQËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 3, e 23, pika 3, shkronja "b", të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 "Për koncesionet", me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autoriteti kontraktues për kryerjen e procedurave ligjore, për dhënien me koncesion, të formës "BOT" (ndërtim, operim dhe transferim), të hidrocentraleve "Helmës 1" e "Helmës 2", është Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.
2. Miratimin e bonusit prej 2 për qind të pikëve, për rezultatin, teknik dhe financiar, në procedurën konkurruese përzgjedhëse (propozim i pakërkuar), që i jepet shoqërisë "KOTE-KO" sh.p.k.
3. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, në procedurën konkurruese, për dhënien me koncesion të hidrocentraleve "Helmës 1" e "Helmës 2", të kërkojë shprehje interesi dhe

të pranojë oferta, për të gjithë pjesën e lirë të skemës, ku përfshihet ndërtimi i këtyre hidrocentraleve.

4. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.922, datë 2.9.2009

PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, PËR DHËNIEN ME KONCESION TË PRODHIMIT E TË KONTROLLIT TË PULLAVE FISKALE, DHE MIRATIMIN E BONUSIT, NË PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE, QË I JEPET SHOQËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 3, e 23, pika 3, shkronja "b", të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 "Për koncesionet", me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autoriteti kontraktues për kryerjen e procedurës ligjore, për dhënien me koncesion të prodhimit e të kontrollit të pullave fiskale, është Ministria e Financave.

2. Miratimin e bonusit prej 5 për qind të pikëve, për rezultatin, teknik e financiar, në procedurën konkurruese përzgjedhëse (propozim i pakërkuar), që i jepet "Sicpa Security Solutions", SA.

3. Ngarkohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.923, datë 2.9.2009

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.98, DATË 27.1.2009 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE DHE TË PROCEDURAVE TË SHITJES SË TROJEVE TË NDËRMARRJEVE APO TË OBJEKTEVE SHTETËRORE, TË VEÇUARA, TË PRIVATIZUARA"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.9967, datë 24.7.2008 "Për miratimin e aktit normativ nr.4, datë 9.7.2008 "Për privatizimin dhe dhënien në përdorim, shoqërive tregtare dhe institucioneve shtetërore, të ndërmarrjeve apo objekteve të veçanta, mjeteve kryesore dhe mjeteve të xhiros së këtyre ndërmarrjeve"", dhe të ligjit nr.7980, datë 27.9.1995 "Për shitblerjen e trojeve", me propozimin e Ministrit të Financave dhe të Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pika 3 e kapitullit I të vendimit nr.98, datë 27.1.2009 të Këshillit të Ministrave, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"3. Të gjitha subjektet, të cilat kanë privatizuar objekte apo ndërmarrje, por, që nuk kanë privatizuar sipërfaqen e truallit, sipas genplanit, që i bashkëlidhet dokumentacionit të privatizimit, duhet ta blejnë këtë truall deri më 30 qershor 2010, si dhe të kenë paguar qiranë e truallit rregullisht, deri në pagesën e vlerës së plotë të çmimit të truallit, brenda afatit të përcaktuar në këtë pikë.".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.924, datë 2.9.2009

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.1672, DATË 24.12.2008, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR MIRATIMIN DHE PUBLIKIMIN ZYRTAR TË NOMENKLATURËS SË KOMBINUAR TË MALLRAVE, 2009"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 1 e 2 të ligjit nr.9461, datë 21.12.2005 "Për nomenklaturën e mallrave dhe tarifën doganore", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në kapitullin 84 të seksionit XVI të tekstit të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave, 2009, që i bashkëlidhet vendimit nr.1672, datë 24.12.2009 të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

1. Përshkrimi i kodit tarifor të sistemit të harmonizuar 8418 30 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"8418 30 "Ngrirës të tipit pingul (me hapje nga lart), që nuk e kalojnë një kapacitet prej 800 1";

2. Përshkrimi i kodit tarifor të sistemit të harmonizuar 8418 40 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“8418 40 “Ngrirës të tipit dollap (me hapje ballore), që nuk e kalojnë një kapacitet prej 900 1”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.930, datë 2.9.2009

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES “PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË MARRËVESHJEN SHTESË TË KONCESIONIT PËR 25 HIDROCENTRALET VENDORE, TË LIDHUR NDËRMJET MINISTRISË SË EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS DHE SHOQËRISË ITALIANE “ESSEGEI”, S.P.A, MIRATUAR ME VENDIMIN NR.148, DATË 22.3.2007 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 124 e 128 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e marrëveshjes “Për disa shtesa dhe ndryshime në marrëveshjen shtesë të koncesionit për 25 hidrocentralet vendore, të lidhur ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe shoqërisë italiane “ESSEGEI”, S.p.A, miratuar me vendimin nr.148, datë 22.3.2007 të Këshillit të Ministrave”, sipas tekstit dhe aneksit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

MARRËVESHJE

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË MARRËVESHJEN SHTESË TË KONCESIONIT TË LIDHUR NDËRMJET MINISTRISË SË EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS DHE SHOQËRISË ITALIANE "ESSEGEI" SPA, PËR 25 HIDROCENTRALET VENDORE, MIRATUAR ME VENDIMIN NR.148, DATË 22.3.2007 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE

Në Tiranë, sot më 28 gusht 2009, para meje notere Fatime B.Meta, anëtare e Dhomës së Noterisë Tiranë, me adresë rruga e Durrësit, p.118, shk.1, ap.1, u paraqitën palët kontraktuese si më poshtë:

Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, përcaktuar si Organi Shtetëror i Autorizuar (OSHA) me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.148, datë 22.3.2007, përfaqësuar nga titullari z.Genc Ruli, i biri i Pëllumbit, i datëlindjes 11.4.1958, madhor dhe me zotësi juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u sigurova nga pasaporta nr.D0000374 dhe shoqëria "ESSEGEI" S.p.A., që më poshtë do të quhet "Koncesionari", përfaqësuar nga administratori i saj z.Giordano Gorini, i biri i Angelos, i datëlindjes 23.8.1965, madhor dhe me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, për identitetin e të cilit u sigurova nga pasaporta nr.AA 2729065,

me vullnetin e tyre të lirë, bien dakord si më poshtë:

Të lidhin këtë marrëveshje koncesioni, si pjesë përbërëse e marrëveshjes së koncesionit të formës ROT, e lidhur ndërmjet OSHA-së dhe kompanisë italiane "ESSEGEI" S.p.A, për rehabilitimin e 25 hidrocentraleve vendore, të miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.467, datë 3.10.2002, të ndryshuar.

HYRJE

Duke marrë në konsideratë:

- kërkesën e OSHA-së për shkëputje nga koncesioni të HEC-eve, ku nuk është investuar për faj të koncesionarit;
- pengesat e hasura nga Koncesionari, jo për faj të tij, gjatë zbatimit të marrëveshjes së koncesionit, edhe pas ndryshimit të marrëveshjes bazë, miratuar me vendimin nr.148, datë 22.3.2007 të Këshillit të Ministrave, të cilat çuan në mosrealizim në kohë të investimeve të parashikuara;
- mirëkuptimin midis dy palëve (OSHA dhe Koncesionari) për shkëputje nga koncesioni të HEC-eve Piqeras, Lozhan dhe Voskpojë, jo vetëm për mungesë investimesh, por edhe për shkak ndërhyrjeje me koncesione të tjera hidroenergjetike me mundësi potenciale më të mëdha, si edhe për vështirësitë e lidhjes me rrjetin elektrik kombëtar të shpërndarjes;
- realizimin e fuqisë totale të instaluar jo më pak se 14 MW,

bëhet e domosdoshme ndërhyrja në disa nene të marrëveshjes shtesë të koncesionit, të miratuar me vendimin nr.148, datë 22.3.2007 të Këshillit të Ministrave.

Sa më sipër, palët kontraktuese bien dakord të bëhen këto ndryshime.

Neni 1

Në tekstin e marrëveshjes shtesë të koncesionit, të miratuar me vendimin nr.148, datë 22.3.2007 të Këshillit të Ministrave:

- kudo ku është shprehur "…sipas tabelës A…/në tabelën A…" zëvendësohet me "…sipas aneksit 1/në aneksin 1, bashkëlidhur kësaj Marrëveshjeje…".

Neni 2

Në nenin 2, fjalët "…Projekti: Rehabilitimi i hidrocentraleve të vegjël vendore, në të gjithë Shqipërinë (0.2-1.2 MWA fuqi), sipas tabelës A bashkëlidhur dhe në përputhje me formën ROT (Rehabilitim, shfrytëzim, transferim)…"zëvendësohen me "…Projekti: Rehabilitimi i hidrocentraleve

të vegjël vendore, në të gjithë Shqipërinë, me fuqi totale të instaluar jo më pak se 14,440 kW, sipas aneksit 1 bashkëlidhur kësaj marrëveshjeje, dhe në përputhje me formën ROT (Rehabilitim, shfrytëzim, transferim)...".

Neni 3

Në nenin 3, fjalët "...për një shumë jo më pak se 10 661 000 (dhjetë milionë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e një mijë) euro..." zëvendësohen me "...për një shumë jo më pak se 9 916 000 (nëntë milionë e nëntëqind e gjashtëmbëdhjetë) euro...".

Neni 4

Në nenin 4, fjalët "... do të jetë në vlerën 10 661 000 euro..." zëvendësohen me "...do të jetë në vlerën jo më pak se 9 916 000 (nëntëmilionë e nëntëqind e gjashtëmbëdhjetë) euro...".

Neni 5

Në nenin 5, fjalët "...Koncesionari garanton të përfundojë projektin brenda datës 31 dhjetor 2009" zëvendësohen me "...Koncesionari garanton të përfundojë projektin brenda datës 31 dhjetor 2010...".

Neni 6

Në fund të nenit 5, shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

"-Trajtimi i hidrocentraleve Piqeras, Lozhan dhe Voskopojë, do të merren në dorëzim dhe do të trajtohen nga Organi Shtetëror i Autorizuar (OSHA) sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.".

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi me nënshkrimin e saj nga palët dhe pasi të jetë miratuar nga Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë.

Ndryshimet përshkruara në nenet 1-6 më lart, kanë fuqi për të dy palët.

Nenet e tjera të marrëveshjes shtesë nuk kanë ndryshuar.

Kjo Marrëveshje mbahet në 5 (pesë) kopje origjinale në gjuhën shqipe dhe nënshkruhet pa vërejtje nga të dyja palët, administratorit, z.Giordani Gorini që është shtetas italian, iu lexuan italisht kontratat nga përkthyesja znj.Edlira Preza, e bija e Bajramit, e datëlindjes 3.11.1969, me nr.pasaporte Z1542284.

Për Organin Shtetëror të Autorizuar
Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës
Përfaqësuar nga z.Genc Ruli

Për Koncesionarin
"ESSEGEI" S.p.A
Përfqësuar nga ing.Giordani Gorini

ANEKS 1

PLAN REHABILITIMI PËR 22 HEC VENDORE							
Nr	**Emri i HEC-it**	**Vendndodhja rrethi**	**Fuqia e instaluar para rehabilitimit (Kw)**	**Fuqia e instaluar pas rehabilitimit (Kw)**	**Prodhimi max vjetor (kWh)**	**Afati i përfundimit të investimit fundi i vitit**	**Investimi (euro)**
1	Arras	Dibër	1200	2400	10,000,000	2009	1,680,000
2	Funares	Librazhd	1000	1000	4,600,000	2009	563,000
3	Dukagjin	Shkodër	640	640	3,200,000	2010	508,000
4	Nikolice	Korçë	500	500	1,800,000	2010	290,000
5	Bulqizë	Bulqizë	400	600	2,000,000	2009	400,000
6	Lurë	Dibër	400	600	1,650,000	2009	225,000
7	Orgjost	Kukës	400	800	3,000,000	2009	430,000
8	Lerkbibaj	Tropojë	400	1200	4,800,000	2010	765,000
9	Velçan	Korçë	320	800	3,000,000	2010	605,000
10	Zerqan	Bulqizë	250	400	2,000,000	2009	250,000
11	Borsh	Sarandë	250	250	750,000	2009	180,000
12	Leshnicë	Sarandë	250	250	750,000	2009	215,000
13	Shoshan	Tropojë	230	3000	12,000,000	2010	1,940,000
14	Ujanik	Skrapar	220	400	1,500,000	2009	282,000
15	Kerpicë	Gramsh	200	200	950,000	2009	180,000
16	Barmash	Kolonjë	200	200	800,000	2009	180,000
17	Lunik	Librazhd	200	200	800,000	2009	160,000
18	Homesh	Bulqizë	150	150	650,000	2009	160,000
19	Muhur	Dibër	250	250	950,000	2010	250,000
20	Rajan	Kolonjë	200	200	1000,000	2010	263,000
21	Marjan	Korçë	200	200	930,000	2010	230,000
22	Treskë 2	Korçë	160	200	600,000	2009	160,000
	Totale		**8,020**	**14,440**	**57,730,000**	**2010**	**9,916,000**

VENDIM
Nr.931, datë 2.9.2009

PËR LEJIMIN E KALIMIT TRANZIT TË DISA AUTOKOLONAVE USHTARAKE ITALIANE, PËRMES TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 16, pika 2, 17, 18 e 19 të ligjit nr.9363, datë 24.3.2005 "Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit", me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e kalimit tranzit, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, në itinerarin Qafë-Thanë-Porti i Durrësit, në datën 3 shtator 2009, të 5 (pesë) autokolonave ushtarake italiane, të përbëra, si më poshtë vijon:

- Autokolona e parë, nga 18 (tetëmbëdhjetë) automjete, 1 (një) trailer dhe 65 (gjashtëdhjetë e pesë) trupa;
- Autokolona e dytë, nga 20 (njëzet) automjete, 2 (dy) trailera dhe 68 (gjashtëdhjetë e tetë) trupa;
- Autokolona e tretë, nga 20 (njëzet) automjete, 16 (gjashtëmbëdhjetë) trailera dhe 28 (njëzet e tetë) trupa;
- Autokolona e katërt, nga 20 (njëzet) automjete, 14 (katërmbëdhjetë) trailera dhe 30 (tridhjetë) trupa;

- Autokolona e pestë, nga 14 (katërmbëdhjetë) automjete, 3 (tre) trailera dhe 27 (njëzet e shtatë) trupa.

2. Lejimin e kalimit tranzit, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, në itinerarin Porti i Durrësit-Qafë-Thanë, në datën 6 shtator 2009, të 6 (gjashtë) autokolonave ushtarake italiane, të përbëra, si më poshtë vijon:

- Autokolona e parë, nga 20 (njëzet) automjete dhe 41 (dyzet e një) trupa;
- Autokolona e dytë, nga 20 (njëzet) automjete dhe 40 (dyzet) trupa;
- Autokolona e tretë, nga 18 (tetëmbëdhjetë) automjete, 1 (një) trailer dhe 41 (dyzet e një) trupa;
- Autokolona e katërt, nga 13 (trembëdhjetë) automjete, 1 (një) trailer dhe 30 (tridhjetë) trupa;
- Autokolona e pestë, nga 19 (nëntëmbëdhjetë) automjete, 15 (pesëmbëdhjetë) trailera dhe 31 (tridhjetë e një) trupa;
- Autokolona e gjashtë, nga 20 (njëzet) automjete, 3 (tre) trailera dhe 43 (dyzet e tre) trupa.

3. Lejimin e kalimit tranzit, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, në itinerarin Qafë-Thanë-Porti i Durrësit, në datën 14 shtator 2009, të 1 (një) autokolone ushtarake italiane, të përbërë nga 2 (dy) automjete dhe 4 (katër) trupa.

4. Pika e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë për autokolonat, që do të kalojnë në datat 3 dhe 14 shtator 2009, është pika e kalimit të kufirit Qafë-Thanë dhe pika e daljes është pika e kalimit të kufirit Porti i Durrësit.

5. Pika e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë për autokolonat, që do të kalojnë në datën 6 shtator 2009, është pika e kalimit të kufirit Porti i Durrësit dhe pika e daljes është pika e kalimit të kufirit Qafë-Thanë.

6. Autokolonat ushtarake italiane, gjatë hyrjes, lëvizjes dhe daljes në/nga territori i Republikës së Shqipërisë, të shoqërohen nga njësi të armatosura të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

7. Ngarkohet Ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.932, datë 2.9.2009

PËR MIRATIMIN, NË PARIM, TË MARRËVESHJES SË GRANTIT, PHRD, NO.TF 093096, PËR PËRGATITJEN E PROJEKTIT TË QEVERISJES, FINANCAVE DHE DHËNIES SË SHËRBIMEVE BASHKIAKE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 e 7 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 "Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare", me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin, në parim, të marrëveshjes së grantit, PHRD, No.TF 093096, për përgatitjen e projektit të qeverisjes, financave dhe dhënies së shërbimeve bashkiake, me një grant 980 000 (nëntëqind e tetëdhjetë mijë) USD.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Banka Botërore
BANKA NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM
SHOQATA NDËRKOMBËTARE PËR ZHVILLIM

1618 h Street N.W.
Washington D.C. 20433
USA

(202) 477-1234
Adresa: INTBAFRAD
Adresa: INDEVAS

26 gusht 2009

SHT Ridvan Bode
Ministri i Financave
Ministria e Financave
Bulevardi: "Dëshmorët e Kombit"
Tiranë, Shqipëri

Re.: Shqipëri: Grandi PHRD për Përgatitjen e Projektit të Qeverisjes, Financave dhe Dhënies së Shërbimeve për Bashkitë
Nr. grantit TF093096

Shkëlqesi:

Në përgjigje të kërkesës për asistencë financiare të bërë në emër të Shqipërisë (Marrësi), jam i lumtur t'ju informoj që Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (Banka Botërore), si administrator i fondeve të grandit të dhënë nga Japonia, propozon dhënien e një grandi për Marrësin në një shumë që nuk kalon nëntëqind e tetëdhjetë mijë dollarë amerikanë (980,000 USD) (Grandi) sipas termave dhe kushteve të parashikuara ose përmendura në këtë letër marrëveshje (Marrëveshja), që përfshin Aneksin e bashkëngjitur, për të asistuar në financimin e aktiviteteve të përshkruar në aneks (Aktivitete).

Marrësi, nëpërmjet konfirmimit të pëlqimit të tij më poshtë, demonstron që është i autorizuar të lidhë këtë Marrëveshje dhe të kryejë aktivitetet në pajtim me termat dhe kushtet e parashikuara ose të referuara në këtë Marrëveshje. Dhënia e grandit nuk përbën apo nënkupton ndonjë detyrim nga ana e Bankës Botërore për të ndihmuar në financimin e ndonjë projekti që mund të rezultojë nga aktivitetet e financuara nga grandi.

Jeni të lutur të konfirmoni pëlqimin e Marrësit për sa më sipër, duke caktuar një punonjës të autorizuar të Marrësit të nënshkruajë dhe vendosë datën në të dy kopjet e bashkëngjitura të kësaj Marrëveshjeje dhe duke kthyer një prej kopjeve të nënshkruara tek Banka Botërore. Me marrjen nga Banka Botërore të kopjes së nënshkruar, kjo Marrëveshje hyn në fuqi në datën e nënshkrimit; me kusht që oferta e kësaj Marrëveshjeje konsiderohet e tërhequr nëse Banka Botërore nuk ka marrë një kopje të nënshkruar të kësaj Marrëveshjeje deri më 31 gusht 2009, përveç kur Banka Botërore cakton një datë të mëvonshme për këtë qëllim.

Sinqerisht i juaji

BANKA NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM

Nga: (firmë)
Jane Armitage
Drejtor Vendi dhe Koordinator Rajonal
për Evropën Juglindore,
Evropën dhe Rajonin e Azisë Qendrore

Rënë dakord:
SHQIPËRIA

Nga: _____
Emri: _____
Titulli: _____
Datë: _____

Bashkëngjitur:

1. Kushte standarde për grandet e dhëna nga Banka Botërore nga fonde të ndryshme, të datës 20 korrik 2006

2. Letër disbursimi e datës 26 gusht 2009, së bashku me udhëzimet disbursimit të Bankës Botërore për projektet, të datës 1 maj, 2006

Grandi PHRD Nr TF093096

Aneks

Neni 1

Kushtet standarde, përkufizime

1.01 Kushtet standarde. (a) Kushtet standarde për Grantet e Dhëna nga Banka Botërore nga fonde të ndryshme të datës 20 korrik, 2006 (kushte standarde) përbëjnë një pjesë integrale të kësaj Marrëveshjeje.

1.02 Përkufizime. Përveç kur konteksti e kërkon ndryshe, termat me germa kapitale të përdorura në këtë Marrëveshje kanë kuptimet që u jepen atyre në kushtet standarde ose në këtë Marrëveshje; me kusht që për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje termi "Projekt", sa herë që përdoret në kushtet standarde do të thotë aktivitetet e përmendura në seksionin 2.01 të këtij aneksi.

Neni 2

Ekzekutimi i grandit

2.01 Objektivat dhe aktivitetet e grandit. Objektivi i grandit është përgatitja e projektit të qeverisjes, financave dhe dhënies së shërbimeve bashkiake (projekti), që ka si objektiva ngritjen e një kuadri për përfshirjen sistematike të sektorit bashkiak dhe mbështetë reformat për të përmirësuar rezultatet e dhënies së shërbimeve nëpërmjet pjesëmarrjes së bashkive dhe ndërmarrjeve të tyre. Projekti është faza e parë e një programi afatgjatë për bashkitë në Shqipëri, që synon të arrijë dhënien e qëndrueshme të shërbimeve bashkiake nëpërmjet forcimit të financave dhe qeverisjes bashkiake dhe ndihmesën për Shqipërinë që të përmbushë kërkesat për aderimin në BE. Projekti synon të mbështesë shërbimet e ujërave, kanalizimeve, mbetjet inerte, rrugët lokale dhe shërbime të tjera që jepen nga bashkitë pjesëmarrëse. Aktivitetet (Aktivitetet) për të cilat jepet grandi përbëhen nga ato aktivitete që mund të kërkohen për përgatitjen e Projektit dhe që janë aprovuar nga Banka Botërore herë pas here. Këto aktivitete mund të përfshijnë përgatitjen e studimeve të fizibilitetit, projektimeve të hollësishme, vlerësimet ambientaliste, sociale, ekonomike dhe të tjera, zhvillimin e planeve për zbatimin e projektit, realizimin e konsultimeve me aktorët, trajnimin në vend, studime dhe seminare, sondazhe dhe dhënien e shërbimeve këshillimore teknike (duke përfshirë auditët) dhe mallrat që kërkohen për realizimin e këtyre aktiviteteve.

2.02 Ekzekutimi i grandit në përgjithësi. Marrësi deklaron përkushtimin e tij për objektivat e projektit dhe grandit. Për këtë qëllim, Marrësi kryen aktivitetet në pajtim me dispozitat e nenit II të kushteve standarde dhe këtij neni II.

2.03 Menaxhimi financiar. (a) Marrësi siguron që sistemi i menaxhimit financiar të mbahet në pajtim me dispozitat e seksionit 2.07 të kushteve standarde.

b) Marrësi, me kërkesë të Bankës Botërore, auditon pasqyrat financiare të aktiviteteve në pajtim me dispozitat e seksionit 2.07(b) të kushteve standarde. Secili auditim i tillë i pasqyrave financiare mbulon periudhën e treguar në kërkesën e Bankës Botërore. Pasqyrat financiare të audituara për secilën periudhë të tillë i jepet Bankës Botërore jo më vonë se gjashtë muaj pas datës së kërkesës së Bankës Botërore.

2.04 Prokurimi

a) Të përgjithshme. Të gjitha mallrat dhe shërbimet e kërkuara për aktivitetet dhe që duhet të financohen nga shumat e Grandit prokurohen në pajtim me kërkesat e parashikuara ose referuara në:

i) Seksionin I (duke përjashtuar paragrafin 1.16) të "Udhëzimeve për prokurimin sipas huave IBRD dhe kreditë IDA" publikuar nga Banka Botërore në maj 2004 (Udhëzimet e prokurimit), në rastin e mallrave; dhe

ii) Seksionet I (duke përjashtuar paragrafin 1.24) dhe IV të "Udhëzimet: Përzgjedhja dhe punësimi i konsulentëve nga huamarrësit e Bankës Botërore") të publikuar nga Banka Botërore (Udhëzimet për Konsulentë) në rastin e shërbimeve të konsulentëve.

b) Përkufizime. Termat me germa kapitale të përdorura në paragrafët e mëposhtëm të këtij seksioni për të përshkruar metoda të caktuara prokurimi ose metodat e rishikimit nga Banka Botërore të kontratave të caktuara, i referohen metodës përkatëse të përshkruar në udhëzimet e prokurimit ose udhëzimet për konsulentët, sipas rastit.

c) Metoda të caktuara të prokurimit të mallrave

Përveç kur Banka Botërore bie dakord ndryshe, mallrat prokurohen sipas kontratave të dhëna mbi bazën e blerjes.

d) Metoda të Caktuara të prokurimit të shërbimeve të konsulentëve

i) Përveç kur parashikohet ndryshe në pikën (ii) më poshtë, shërbimet e konsulentëve prokurohen sipas kontratave të dhëna mbi bazën e përzgjedhjes sipas cilësisë dhe kostos.

ii) Metodat e mëposhtme mund të përdoren për prokurimin e shërbimeve të konsulentëve për ato detyra që Banka Botërore bie dakord se përmbushin kërkesat e parashikuara në udhëzimet e konsulentëve për përdorimin e tyre: (A) Përzgjedhje e bazuar në cilësi; (B) Përzgjedhje e bazuar në një buxhet të caktuar; (C) Përzgjedhja me koston më të ulët; (D) Përzgjedhje e bazuar në kualifikimet e konsulentëve; (E) Përzgjedhja me një burim; (F) Përzgjedhje e konsulentëve individuale; dhe (G) Procedurat me burim të vetëm për përzgjedhjen e konsulentëve individuale.

e) Rishikimi nga Banka Botërore i vendimeve të prokurimit. Përveç kur Banka Botërore përcakton ndryshe nëpërmjet një njoftimi drejtuar Marrësit, kontrata e parë që duhet të jepet në bazë të çdo metode prokurimi i nënshtrohet Rishikimit Paraprak nga Banka Botërore. Të gjitha kontratat e tjera i nënshtrohen rishikimit pasues nga Banka Botërore.

Neni 3

Tërheqjet e shumave të grandit

3.01 Shpenzime të përshtatshme. Marrësi mund të tërheqë shumat e grandit në pajtim me dispozitat e: (a) kushteve standarde, (b) këtij seksioni, dhe (c) çdo udhëzimi shtesë që Banka Botërore mund të përcaktojë duke njoftuar Marrësin (duke përfshirë udhëzimet e Bankës Botërore për disbursimin për projektet" të muajit maj 2006, që rishikohet herë pas here nga Banka Botërore dhe që bëhet e zbatueshme në këtë Marrëveshje në pajtim me këto udhëzime), për të financuar shpenzimet e përshtatshme të përcaktuara në tabelën e mëposhtme. Tabela përcakton kategoritë e shpenzimeve të përshtatshme që mund të financohen nga shumat e grandit (Kategori), alokimin e shumave të grandit për secilën kategori, dhe përqindjen e shpenzimeve që duhet të financohen për shpenzimet e përshtatshme në secilën Kategori:

Kategoria	**Shuma e grandit e alokuar (shprehur në USD)**	**Përqindja e shpenzimeve që duhet të financohet**
1) Shërbime konsulentësh	900,000	100%
2) Kosto për mallra, trajnime dhe kosto operative	80,000	100%
Totali	980,000	

Për qëllimet e këtij seksioni: (i) termi "trajnim" do të thotë trajnim i kryer në territorin e Marrësit, duke përfshirë blerjen dhe publikimin e materialeve, qiranë e ambienteve, tarifat e kursit dhe udhëtimin dhe qëndrimin e pjesëmarrësve; dhe (ii) termi "kosto operative" janë kostot operative që kërkohen për aktivitetet duke përfshirë materialet e konsumit dhe furnizimet, komunikimet, shërbimet e medias dhe printimit, qiranë e automjeteve, operimin dhe mirëmbajtjen, tarifat për hapjen dhe operimin e llogarive bankare që kërkohen për aktivitetet, dhe udhëtimin, fjetjen dhe dietat, por duke përjashtuar pagat e punonjësve të shërbimit civil të Marrësit.

3.02 Kushtet e tërheqjes. Pavarësisht nga dispozitat e seksionit 3.01 të kësaj Marrëveshjeje, asnjë tërheqje nuk bëhet për pagesat e bëra para datës së nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje nga Marrësi.

3.03 Periudha e tërheqjes. Data e mbylljes e përmendur në seksionin 3.06 (c) të kushteve standarde është 31 mars 2011.

Neni 4

Përfaqësuesi i marrësit; adresat

4.01 Përfaqësuesi i Marrësit. Përfaqësuesi i Marrësit i përmendur në seksionin 7.02 të kushteve standarde është:

4.02 Adresa e Marrësit. Adresa e Marrësit e përmendur në seksionin 7.01 të kushteve standarde është Ministri i Financave.

Ministria e Financave
"Dëshmorët e Kombit"
NR 4, Tirana, Shqipëri
Faks. +355 42 28494

4.03 Adresa e Bankës Botërore. Adresa e Bankës Botërore e përmendur në seksionin 7.01 të kushteve standarde është:

International Development Association
1818 H Street N.W
Washington D.C. 20433
United States of America

Cable:	Teleks:	Faks.
INDVAS	248423(MCI) ose	1-202-477-6391
Washington D.C.	64145(MCI)	

Banka Botërore
BANKE NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM
SHOQATA NDËRKOMBËTARE PËR ZHVILLIM

1618 h Street N.W.
Washington D.C. 20433
U.S.A.

(202) 477-1234
Adresa: INTBAFRAD
Adresa: INDEVAS

26 gusht 2009

SHT Ridvan Bode
Ministër i Financave
Ministria e Financave
Bulevardi "Dëshmorët e Kombit"
Tiranë, Shqipëri

Shkëlqesi:

Re.: Nr Grantit PHRD TF093096-AL për përgatitjen e projektit të qeverisjes, financave dhe dhënies së shërbimeve bashkiake
Udhëzime Shtesë: Disbursime

I referohem letër marrëveshjes Marrëveshja ndërmjet Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim Banka Botërore si administratore e fondeve të grandit të dhëna nga Japonia, dhe Shqipërisë Marrësi për projektin e përmendur më sipër, të datës 26 gusht 2009. Marrëveshja parashikon që Banka Botërore mund të nxjerrë udhëzime shtesë në lidhje me tërheqjen e shumave të grantit nr TF093096_AL Grandi. Kjo letër Letër Disbursimi, e rishikuar herë pas here, përbën udhëzime shtesë.

Udhëzimet e Bankës Botërore për disbursimet për projektet të datës 1 maj 2006, bashkëngjitur, Udhëzimet e Disbursimit (shtojca 1), janë një pjesë përbërëse e letrës së disbursimit. Mënyra në të cilën dispozitat e udhëzimeve të disbursimit zbatohen për grantin është e përcaktuar më poshtë. Seksionet dhe nën-seksionet në parantezë më poshtë u referohen seksioneve dhe nënseksioneve përkatëse në udhëzimet e disbursimit dhe, përveç kur përcaktohet ndryshe në këtë letër, termat me germa kapitale të përdorura kanë kuptimet që u jepen atyre në udhëzimet e disbursimit.

I. Masat e disbursimit

i) Metodat e disbursimit (seksioni 2). Metodat e mëposhtme të disbursimit mund të përdoren për këtë grand:

- Rimbursim;
- Parapagim;
- Pagesë e drejtpërdrejtë;
- Detyrim i veçantë.

ii) Data e fundit e disbursimit (nënseksioni 3.7). Data e fundit e disbursimit është 4 muaj pas datës së mbylljes së përcaktuar në Marrëveshjen e Huasë. Çdo ndryshim deri në këtë datë njoftohet nga Banka Botërore.

II. Tërheqjet e shumave të grantit

i) Nënshkrimet e autorizuara (nënseksioni 3.1)

Një letër në formën e bashkëngjitur (shtojcë 2) duhet t'i jepet Bankës Botërore në adresën e treguar më poshtë duke dhëne emrin(at) dhe ekzemplarët e firmave të punonjësve të autorizuar për të nënshkruar kërkesat:

The World Bank
1818 H Street N.W
Washington D.C. 20433
United States of America

Në vëmendje të: Jane, Armitage, Drejtor Vendi dhe Koordinator Rajonal për Europën JugLindore (Rajoni ECA).

ii) Kërkesat (nënseksionet 3.2-3.3) Jeni të lutur të paraqisni të plotësuar dhe nënshkruar (a) kërkesat për tërheqje, së bashku me dokumentet shoqëruese, dhe (b) kërkesat për kontribute të veçanta, së bashku me një kopje të letrës së kredisë së bankës tregtare, në adresën e treguar më poshtë:

The World Bank
Radnicka cesta 80, 9th floor
Zagreb, HR-10 000,
Croatia

Në vëmendje të: grupi i menaxhimit të disbursimit.

iii) Vlera minimale e kërkesave (nënseksioni 3.5) Vlera minimale e kërkesave për pagesë të drejtpërdrejtë dhe/ose lëshimin e kontributeve të veçanta është ekuivalenti i 19,600 USD.

iv) Parapagimet (seksionet 5 dhe 6)

- Tipi i llogarisë së caktuar (nënseksioni 5.3): E ndarë;
- Monedha e llogarisë së caktuar (nënseksioni 5.4): Dollarë amerikanë (USD);
- Institucioni financiar ku llogaria e caktuar do të hapet (nënseksioni 5.5): në një bankë tregtare të pranueshme për bankën;
- Tavani (nënseksioni 6.1): 98,000 USD.

III. Raportimi mbi përdorimin e shumave të huasë

i) Dokumentacioni shoqërues (seksioni 4) Dokumentacioni shoqërues duhet të paraqitet me secilën kërkesë për tërheqje sipas parashikimit të mëposhtëm:

- Për kërkesat për riimbursim:
- Lista e pagesave kundrejt kontratave që i nënshtrohen rishikimit paraprak të Bankës Botërore, në formën e bashkëngjitur (shtojca 4);
- Regjistrat që evidentojnë shpenzimet e përshtatshme (p.sh., kopje të faturave, fatura të furnitorëve/konsulentëve)) për pagesat për shërbimet e konsulentëve kundrejt kontratave të vlerësuara me ekuivalentin e 100,000 USD ose më shumë për firma dhe me ekuivalentin e 50,000 USD për konsulentët individë;
- Pasqyrat e shpenzimeve në formën e bashkëngjitur (shtojca 3) për të gjitha shpenzimet / kontratat;
- Për raportimin e shpenzimeve të përshtatshme të paguara nga llogaria e caktuar:
- Lista e pagesave kundrejt kontratave që i nënshtrohen rishikimit paraprak të Bankës Botërore, në formën e bashkëngjitur (shtojca 4);
- Regjistrat që evidentojnë shpenzimet e përshtatshme (p.sh., kopje të faturave, fatura të furnitorëve/konsulentëve)) për pagesat për shërbimet e konsulentëve kundrejt kontratave të vlerësuara me ekuivalentin e 100,000 USD ose më shumë për firma dhe me ekuivalentin e 50,000 USD për konsulentët individë;
- Pasqyrat e shpenzimeve në formën e bashkëngjitur (shtojca 3) për të gjitha shpenzimet / kontratat.
- Për kërkesat për pagesë të drejtpërdrejtë: regjistrat që evidentojnë shpenzime të përshtatshme p.sh., kopje për fatura, fatura të furnitorëve.

ii) Frekuenca e raportimit të shpenzimeve të përshtatshme të paguara nga llogaria e caktuar (nënseksioni 6.3). Kërkesat për plotësim duhet të paraqiten çdo muaj. Kërkesa për plotësim duhet të përfshijë pasqyrat e bashkërenduara të bankës, si dhe dokumentet e tjera të përshtatshme shoqëruese.

IV. Informacion tjetër i rëndësishëm

Për informacion shtesë mbi masat e disbursimeve, jeni të lutur t'i referoheni manualit të disbursimit që ofrohet në faqen publike të Bankës Botërore te http://www.worldbank.org dhe faqet e sigurta "Client Connection" te http://clientconnection.worldbank.org. Kopje të printuara ofrohen me kërkesë.

Nëse nuk e keni bërë këtë, Banka Botërore rekomandon që ju të regjistroheni si përdorues i faqes Client Connection http://clientconnection.worldbank.org. Nga kjo faqe ju do të jeni në gjendje të shkarkoni Kërkesat, të monitoroni statusin gati në kohë reale të grantit dhe të nxirrni

informacionin përkatës politik, financiar dhe për prokurimin. Për më tepër informacion në lidhje me faqen e internetit dhe masat e regjistrimit, jeni të lutur të kontaktoni Bankën Botërore me e-mail tek <clientconnection@worldbank.org>.

Nëse keni ndonjë pyetje në lidhje me sa më sipër, jeni të lutur të kontaktoni z.Nicholay Chistyakov, financier i lartë te loa-eca@worldbank.org duke përdorur referencën e mësipërme.

Sinqerisht i juaji

IDA/IBRD

Nga: (firmë)
Jane Armitage
Drejtor Vendi dhe Koordinator Rajonal
për Europën Jug-Lindore,
Europën dhe Rajonin e Azisë Qendrore

Shtojcë
1. Udhëzimet e Bankës Botërore për disbursimet për projektet, datë 1 maj 2006.
2. Formulari i firmave të autorizuara.
3. Formulari i "Pasqyra e shpenzimeve".
4. Formulari i pagesave kundrejt kontratave që i nënshtrohen rishikimit paraprak të Bankës Botërore

Përgatitur nga NEC

Për dijeni: Sherefedin Shehu, zëvendësministër
Ministria e Financave
Blvd. "Dëshmorët e Kombit"
Tirana, Shqipëri

Miratuar dhe për dijeni: J. Rieger, LEGEM
W. Zakout, ECSS6
J. Kamkëalala, ECSS6
Y. Zhang, ECSS6

Shtojcë (2)

(Koka e letrës)
Ministria e Financave
(Adresa e rrugës)
(Qyteti, Vendi)

(Datë)

The World Bank
1818 H Street N.W
Washington D.C. 20433
United States of America

Në vëmendje të: (Drejtor Vendi)

I nderuar (Drejtor Vendi):

Lënda:

I referohem Marrëveshjes së grandit ("Marrëveshja") ndërmjet Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim "Banka Botërore" dhe Shqipërisë "Marrësi", datë _____, që parashikon grantin e mësipërm. Për qëllimet e seksionit 3.04(b) të kushteve standarde, sipas parashikimit në Marrëveshje, cilido[1] nga personat, ekzemplarët autentikë të firmave të të cilëve janë më poshtë, autorizohet në emër të Marrësit të nënshkruajë kërkesat për tërheqje (dhe kërkesat për një kontribut të veçantë) sipas këtij Grandi:

Emër, pozicioni, Ekzemplari i firmës: _____
Emër, pozicioni, Ekzemplari i firmës: _____
Emër, pozicioni, Ekzemplari i firmës: _____

Sinqerisht i juaji
(firmë)

_____
(pozicioni)

[1] Udhëzimi për Marrësin për dërgimin e kësaj letre te Banka Botërore: Përcakto nëse kërkesën duhet ta nënshkruajë më shumë se një person dhe sa ose cilët pozicione dhe nëse zbatohet ndonjë kufizim.

Shtojca 4

PAGESAT E BËRA GJATË PERIUDHËS SË RAPORTIMIT
KUNDREJT KONTRATAVE QË I NËNSHTROHEN RISHIKIMIT PARAPRAK TË SHOQATËS

VENDIM
Nr.934, datë 2.9.2009

PËR PËRCAKTIMIN E SHTETEVE, ME NIVEL TË MJAFTUESHËM TË MBROJTJES SË TË DHËNAVE PERSONALE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të nenit 8 të ligjit nr.9887, datë 10.3.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shtetet, që kanë nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale, janë:

a) Shtetet anëtare të Bashkimit Europian;

b) Shtetet anëtare të Zonës Ekonomike Europiane;

c) Shtetet, që kanë ratifikuar konventën nr.108 të vitit 1981 "Për mbrojtjen e individëve nga përpunimi automatik i të dhënave personale", si dhe protokollin shtesë të saj, që garantojnë mbrojtjen e mjaftueshme të të dhënave personale, në përputhje me të gjitha kërkesat e direktivës 95/46/EC, të Parlamentit dhe Këshillit Europian, datë 24 tetor 1995 "Për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin e të dhënave personale dhe qarkullimin e lirë së të dhënave të tilla";

ç) Shtetet, ku mund të transferohen të dhënat personale, sipas një vendimi të Komisionit të Bashkimit Europian.

2. Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale është autoriteti përgjegjës për nxjerrjen e vendimeve të duhura për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.939, datë 3.9.2009

PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË TJERA TË STUDIMIT, PRANË SHKOLLËS SË LARTË UNIVERSITARE, PRIVATE "UNIVERSITY OF NEW YORK, TIRANA"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, pika 2, 43, 44 e 45 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e shkollës së lartë universitare, private "University of New York, Tirana", Tiranë në bashkëpunim me universitetin e Grenwich-it, Britania e Madhe, për hapjen e programit të studimit, të ciklit të parë, në formën e studimeve me kohë të plotë, në B.Sc, në "Inxhinieri të infrastrukturës së rrjeteve kompjuterike", ekuivalente me "Diplomë e nivelit të parë", (DNP), në "Inxhinieri të infrastrukturës së rrjeteve kompjuterike".

2. Kohëzgjatja normale e këtij programi studimi, të ciklit të parë, të jetë 3 (tri) vite akademike, me plotësimin e 180 krediteve.

3. Lejimin e shkollës së lartë universitare, private "University of New York, Tirana", Tiranë, në bashkëpunim me universitetin Grenwinch-it, Britania e Madhe, për hapjen e programeve të studimit, të ciklit të dytë, në formën e studimeve me kohë të plotë në:

a) Ll.M., në “E drejta ndërkombëtare dhe tregtare”, ekuivalente me “Diplomë e nivelit të dytë” (DND), në “E drejta ndërkombëtare dhe tregtare”;

b) M.Sc., në “Shkencat kompjuterike, ekuivalente me Diplomë e nivelit të dytë (DND), në Shkencat kompjuterike;

c) M.Sc., në “Financë dhe kontabilitet”, ekuivalente me “Diplomë e nivelit të dytë“ (DND), në “Financë dhe kontabilitet”;

ç) M.A., në “Çështje (marrëdhënie) ndërkombëtare”, ekuivalente me “Diplomë e nivelit të dytë“, (DND), në “Çështje (marrëdhënie) ndërkombëtare”.

4. Kohëzgjatja normale e këtyre programeve të studimit të jetë, së paku, 1 (një) vit akademik, me plotësimin e së paku 60 krediteve. Në këto programe studimi do të pranohen kandidatët, që kanë fituar një diplomë, në përfundim të një programi studimi, të ciklit të parë, me kohëzgjatje normale 4 vite, me plotësimin e 240 krediteve, pas përshtatjes së studimeve, sipas Bolonjës, ose që zotërojnë një diplomë tjetër, ekuivalente me të.

5. Lejimin e shkollës së lartë universitare, private “University of New York, Tirana”, Tiranë, për hapjen e programit të integruar të studimit të ciklit të dytë, në formën e studimeve me kohë të plotë për “Drejtësi”. Kohëzgjatja normale e këtij programi të jetë 5 vite, në plotësimin e 300 krediteve. Në përfundim të programit të studimit lëshohet “Diplomë e integruar e nivelit të dytë” (DIND), në “Drejtësi”.

6. Ngarkohet shkolla e lartë universitare, private “University of New York, Tirana”, që, për çdo program studimi, pas vitit të parë të sigurojë, nëpërmjet marrëdhënieve kontraktuale, zhvillimin e disa prej disiplinave kryesore formuese të specialitetit, nga një personel akademik i huaj, me kualifikimin e nevojshëm.

7. Shkolla e lartë universitare, private “University of New York, Tirana”, ta fillojë veprimtarinë mësimore për programet e studimit, të përcaktuar në këtë vendim, pasi të ketë marrë lejen përkatëse nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës, por jo më vonë se dy javë para fillimit të vitit akademik.

Ministri e lëshon lejen, pasi vlerëson se institucioni mësimor ka përmbushur angazhimet e deklaruara, në përputhje me udhëzimin e tij për këtë qëllim.

8. Ndryshimet në vendndodhje, plane, forma studimi dhe programe, si dhe në elemente të tjera, të miratuara, bëhen pas miratimit nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

9. Shkolla e lartë universitare, private “University of New York, Tirana”, duhet t’i nënshtrohet procesit të akreditimit të këtyre programeve të studimit, brenda afateve të përcaktuara në ligjin në fuqi.

10. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucion dhe për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.940, datë 4.9.2009

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.1694, DATË 24.12.2008 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR PËRCAKTIMIN E NUMRIT TË PUNONJËSVE, PËR VITIN 2009, NË MINISTRITË DHE INSTITUCIONET QENDRORE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 10 të ligjit nr.10025, datë 27.11.2008 "Për buxhetin e vitit 2009", me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.1694, datë 24.12.2008 të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"1.Numri i punonjësve buxhetorë, për vitin 2009, në ministritë dhe institucionet qendrore, bëhet 89 882 veta, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.".

2. Në numrin e punonjësve, të miratuar për vitin 2009:

a) Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës t'i shtohen edhe 10 veta, për sistemin e arkivës;

b) Ministrisë së Mbrojtjes t'i pakësohen 12 veta, si pasojë e kalimit të administrimit të Spitalit Ushtarak të Gjirokastrës, pranë Ministrisë së Shëndetësisë;

c) Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit t'i shtohen 3 veta, si rezultat i shtimit të funksioneve, zëvendësministër, sekretar dhe shofer.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe ministritë e përmendura në pikën 2 të vendimit, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe efektet financiare për shkronjën "c" të pikës 2 të këtij vendimi, nisin nga data 13.5.2009.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr.1

Gr.	Ministritë/institucionet	Viti 2009
3	**Kryeministria**	**128**
4	**Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, nga e cila:**	**784**
	- Drejtoria e Standardeve	18
	- Shërbimi Gjeologjik Shqiptar	135
	- Drejtoria e Metereologjisë e Kalibrimit	110
	- Qendra Kombëtare e Licencimit	35
5	**Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit**, nga e cila:	**2 198**
	- Bordet e kullimit	650
	- Agjencia e pagesave	86
6	**Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit**	**1 363**
10	**Ministria e Financave,** nga e cila:	**3 203**
	- Drejtoria e Përgjithshme e Doganave	1 062
	- Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve	1 616
	- Drejtoria e Përgjithshme Parandalimit Pastrimit Parave	26
	- Agjencia e Lojërave të Fatit	25
11	**Ministria e Arsimit dhe Shkencës**	**39.231**
	Parauniversitar	38 241
12	**Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve**	**1 103**
13	**Ministria e Shëndetësisë**	**3 530**
14	**Ministria e Drejtësisë,** nga e cila	**5 026**
	- Avokati i Shtetit	55
	- Zyra e Regjistrimit të Pasurive	550
	- Agjencia Kombëtare e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave	150
	- Shërbim i Provës	50
15	**Ministria e Punëve të Jashtme**	**188**
	Ambasadat dhe përfaqësitë	**428**
16	**Ministria e Brendshme,** nga e cila:	**13 305**
	-Drejtoria e Rezervave të Shtetit	100
17	**Ministria e Mbrojtjes**	**11 779**
18	**Shërbimi Informativ Shtetëror**	**950**
20	**Drejtoria e Përgjthshme e Arkivave**	**155**
22	**Akademia e Shkencave**	**31**
25	**Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta**	**1 434**
26	**Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave**	**1 399**
31	**Agjencia Telegrafike Shqiptare**	**82**
50	**Instituti i Statistikës**	**169**
57	**Qendra Kombëtare e Kinematografisë**	**10**
59	**Instituti i Rehabilitimit të të Përndjekurve Politikë**	**25**
78	**Ministria e Integrimit**	**77**
82	**Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit**	**6**
87	**Institucione të tjera qeveritare,** nga të cilat:	**103**
	-Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar	38
	- Agjencia e Prokurimit Publik	36
	- Komiteti Shtetëror i Minoriteteve	9
	- Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit	20
	Total numri punonjësve	**86 707**
	Numri i punonjësve në institucionet e pavarura	**3 175**
	Total numri punonjësve buxhetorë	**89 882**

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Zhan d'Ark", prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 2258 472 (Kryeredaktori).
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2009 është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI I PROCEDURËS CIVILE	240 lekë
KODI PENAL	226 lekë
KODI I PROCEDURËS PENALE.....	330 lekë
KODI CIVIL	410 lekë
KODI I PUNËS	140 lekë
KODI PENAL USHTARAK	55 lekë
KODI I FAMILJES	270 lekë
KUSHTETUTA	95 lekë
KODI I PROCEDURËS ADMINISTRATIVE	90 lekë
PËRMBLEDHËSE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë

Hyri në shtyp më 5.10.2009
Doli nga shtypi më 6.10.2009

Tirazhi: 3300 copë	Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2009

Çmimi 40 lekë